



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"  
KORÇË**

---

# **STATUTI I UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË**

Miratuar me Urdhrin nr.56, datë 08.02.2018, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## PËRMBAJTJA

<b>KREU I</b> .....	5
<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b> .....	5
Neni 1.Të përgjithshme.....	5
Neni 2.Misioni dhe Vizioni.....	5
Neni 3.Parime organizative.Liria akademike dhe autonomia.....	6
<b>KREU II</b> .....	7
<b>UNIVERSITETI I KORÇËS - STRUKTURA ORGANIZATIVE, TË DREJTA DHE DETYRIME</b> .....	7
Neni 4.A. STRUKTURA ORGANIZATIVE (Universiteti) .....	7
Neni 5.B. ORGANIZIMI I BRENDSHËM (Njësitë kryesore) .....	9
Neni 6.Njësitë bazë .....	9
Neni 7.Strukturat ndihmësakademike .....	10
Neni 8. Strukturat Akademike .....	11
<b>KREU III</b> .....	12
<b>UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” – ORGANIZIMI DHE DREJTIMI AKADEMIK</b>	
Neni 9.Organet Kolegjiale dhe Autoritetet Drejtuese.....	12
Neni 10.Senati Akademik .....	12
Neni 11.Funksionet e Senatit Akademik .....	13
Neni 12.Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik .....	15
Neni 13.Rektori.....	15
Neni 14.Zëvendësrektori/ët.....	16
Neni 15.Përgjegjësitë dhe kompetencat e zëvendësrektorëve .....	17
Neni 16.Largimi nga detyra i zëvendësrektorëve .....	17
Neni 17.Rektorati.....	17
Neni 18.Dekani .....	18
Neni 19.Zëvendësdekani.....	19
Neni 20.Dekanati .....	20
Neni 21.Drejtuesi i Njësisë Bazë .....	20
Neni 22.Drejtuesi i Grupit mësimor dhe kërkimor .....	22
Neni 23.Këshilli i Etikës .....	22
Neni 24.Bordi Këshillimor.....	23
Neni 25.Komisionet e Përhershme .....	23
<b>KREU IV</b> .....	23
<b>UNIVERSITETI “FAN S. NOLI I KORÇËS, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV</b> .....	23
Neni 26.Krijimi dhe përbërja e Bordit të Administrimit.....	23
Neni 27.Funksionet e Bordit të Administrimit .....	24
Neni 28.Mbarimi i parakohshëm i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit.....	24
Neni 29.Përzgjedhja dhe statusi i Administratorit të UK-së.....	25
Neni 30.Funksionet e Administratorit të UK-së .....	25
Neni 31.Përzgjedhja dhe Statusi i Administratorit të Njësisë Kryesore .....	26
Neni 32.Funksionet e administratorit të Njësisë Kryesore .....	26
<b>KREU V</b> .....	27
<b>UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” - PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV</b> .....	27
Neni 33.Të përgjithshme.....	27
Neni 34.Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik.....	27
Neni 35.Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik.....	29
Neni 36.Kategoritë e personelit akademik.....	29

Neni 37.Titujt dhe vlerësimet e tjera.....	30
Neni 38.Personeli akademik i ftuar.....	30
Neni 39.Viti akademik sabbatik.....	31
Neni 40.Punësimi i personelit akademik .....	31
Neni 41.Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik.....	31
Neni 42.Masat disiplinore për personelin akademik.....	32
Neni 43.Personeli ndihmësakademik.....	32
Neni 44.Personeli administrativ .....	33
Neni 45.Zgjidhja e kontratës së punës .....	33
<b>KREU VI.....</b>	<b>34</b>
<b>PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE.....</b>	<b>34</b>
Neni 46.Format e studimeve dhe pranimi i studentëve.....	34
Neni 47.Programet e studimit në UK.....	34
Neni 48.Programet e studimit me karakter profesional.....	34
Neni 49.Programet e Ciklit të Parë të Studimeve .....	35
Neni 50.Pranimi në Ciklin e Parë të Studimeve .....	35
Neni 51.Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve.....	35
Neni 52.Pranimi në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve .....	36
Neni 53.Cikli i Tretë i Studimeve (Studimet e doktoratës) .....	36
Neni 54.Pranimi në Studimet e Doktoratës.....	37
Neni 55.Programet e përbashkëta të studimit .....	37
Neni 56.Programet e studimeve të formimit të vazhduar .....	37
Neni 57.Programet e studimit në fushën e mësuesisë.....	38
Neni 58.Ndjekja e një programi të dytë studimi .....	38
Neni 59.Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies .....	38
Neni 60.Gjuha e studimeve.....	39
Neni 61.Transferimi i Studimeve.....	39
Neni 62.Kohëzgjatja e studimeve .....	40
Neni 63.Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës.....	40
<b>KREU VII .....</b>	<b>40</b>
<b>KËRKIMI DHE VEPRIMTARIA SHKENCORE .....</b>	<b>40</b>
Neni 64.Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UK .....	40
Neni 65.Veprimtaritë kërkimore në UK .....	41
Neni 66.Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore .....	42
<b>KREU VIII .....</b>	<b>42</b>
<b>STUDENTËT, TË DREJTAT, DETYRIMET DHE TË DHËNAT PËR TA .....</b>	<b>42</b>
Neni 67.Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit .....	42
Neni 68.Të drejtat dhe detyrimet e studentit.....	42
Neni 69.Këshillat e Studentëve.....	43
Neni 70.Masat disiplinore për studentët .....	43
Neni 71.Dokumentacioni i procesit mësimor .....	44
Neni 72.Baza e të dhënave të studentëve.....	44
<b>KREU IX.....</b>	<b>44</b>
<b>SIGURIMI I CILËSISË .....</b>	<b>44</b>
Neni 73.Organizimi strukturor.....	44
Neni 74.Sigurimi i Cilësisë .....	45
<b>KREU X .....</b>	<b>45</b>
<b>PRONAT DHE FINANCIMI I UK-së, MARRËDHËNIET ADMINISTRATIVE</b>	
<b>DHE FINANCIARE .....</b>	<b>45</b>
Neni 75.Pronat e paluajtshme të UK-së.....	45

Neni 76.Financimi i UK-së .....	46
Neni 77.Autonomia financiare e UK-së.....	46
Neni 78.Burimet e financimit të UK-së .....	46
Neni 79. Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit .....	46
Neni 80.Granti i politikave të zhvillimit .....	47
Neni 81.Granti i mësimdhënies.....	47
Neni 82.Granti i punës kërkimore-shkencore .....	48
Neni 83.Administrimi i çështjeve financiare .....	48
Neni 84.Marrëdhëniet financiare .....	48
Neni 85.Kontrolli dhe auditimi .....	48
<b>KREU XI</b> .....	49
<b>PROCEDURAT ZGJEDHORE</b> .....	49
Neni 86.Asambleja e personelit akademik.....	49
Neni 87.Procedura të zgjedhjeve në UK.....	49
<b>KREU XII</b> .....	49
<b>DISPOZITA TË FUNDIT</b> .....	49
Neni 88.Vula & Stema.....	50
Neni 89.Simbolet .....	50
Neni 90.Miratimi i rregulloreve.....	50
Neni 91.Hyrja në fuqi .....	50
Neni 92.Dispozita kalimtare.....	50
<b>ANEKSE:</b> .....	51

**STATUTI**  
**I**  
**UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI ” TË KORÇËS**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Të përgjithshme**

1. Ky Statut është hartuar në zbatim të nenit 33, të Ligjit nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe pasqyron organizimin e strukturimit të brendshëm të Universitetit “Fan S. Noli” (më tej UK), të programeve të studimit në zbatim të këtij ligji, si dhe të gjithë legjisllacionit tjetër në fuqi për arsimin e lartë.

2. Statuti i UK-së përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe në të cilin përcaktohen hollësisht parimet, organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ, të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

3. Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës është Institucion i Arsimit të Lartë Publik (IALP) që financohet nga shteti dhe nga burime të tjera të ligjshme.

4. Ai është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr.5, dt. 07. 01.1992, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971. Universiteti i Korçës mban emrin zyrtar “Fan S. Noli”, dhënë në vitin 1994, me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Veprimtaria e UK-së bazohet në nenin 57, pika 7, në nenin 58 të Kushtetutës, në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), në akte të tjera ligjore e nënligjore, në këtë Statut, si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme, të miratuara apo të dala në zbatim të tij, duke reflektuar parimet dhe objektivat e procesit të Bolonjës.

6. Selia qendrore e UK-së është Shëtitore “Rilindasit”, Korçë. Njësitë e tjera kanë selitë e tyre të përcaktuara në rregulloret respektive.

7. UK-ja ka simbolet e tij, të cilat janë paraqitur në anekset bashkëlidhur këtij Statuti.

**Neni 2**  
**Misioni dhe Vizioni**

1. UK-ja në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

- të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.

- të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimet kryesore të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese ;

- si promotor i formës më të lartë të arsimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.

- të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;

- të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

2. t'u sigurojë punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij statuti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. të lëshojë diploma dhe të japë certifikata e tituj të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer.

4. të garantojë shprehjen e lirë të ideve dhe t'i sigurojë personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.

### Neni 3

#### Parime organizative

#### Liria akademike dhe autonomia

Si një Institucion Publik i Arsimit të Lartë, UK-ja gëzon liri akademike, autonomi financiare, autonomi organizative dhe autonomi të përzgjedhjes së personelit:

1. **Liria akademike** sigurohet nëpërmjet së drejtës:

- për të shprehur hapur mendimet e lira për probleme që lidhen me përmbushjen e qëllimeve të universitetit.

- për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, të transferimit të njohurive, si dhe veprimtaritë krijuese.

- për të marrë pjesë, nëpërmjet aplikimit, në thirrjet për projekte zhvilluese të financuara nga organizata ndërkombëtare dhe programeve të posaçme të BE-së.

- për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

- për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

- për të vendosur lidhje me institucione të tjera të arsimit të lartë (vendase dhe të huaja), për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në mësimdhënie, në kërkimin shkencor, si dhe për kualifikimin e personelit.

- për të vendosur marrëdhënie dhe për t'u bërë anëtar i shoqatave dhe organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare të shkollave të larta, si dhe për të bashkëpunuar me subjekte, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e universitetit.

- për të lëshuar diploma, certifikata apo tituj të tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me nivelin e formimit të kryer.

2. **Autonomia financiare** sigurohet nëpërmjet së drejtës:

- për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike dhe sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- për të përfutuar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë.

- për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të UK-së.

- për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që UK-ja zotëron ligjërisht, në përputhje me misionin e tij.

3. **Autonomia organizative** dhe e përzgjedhjes së personelit sigurohet nëpërmjet së drejtës:

- për t’u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tij nëpërmjet akteve të brendshme, të hartuara në përputhje me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

- për të caktuar kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit që ofron UK-ja, në përputhje me ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme.

- për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij.

4. Shteti garanton paprekshmërinë e UK-së dhe të territorit të tij. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me lejë ose me kërkesë të rektorit të UK-së, përveç rasteve të kryerjes së një vepre penale flagrante, të fatkeqësive natyrore dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

5. UK-ja garanton dhe favorizon publikimin e vendimeve, udhëzimeve, akteve të nxjerra nga ministria e linjës, apo edhe nga organet e tij drejtuese, me përjashtim të atyre me karakter thellësisht privat apo konfidencial. Publikimi kryhet me anë të shpalljes apo të shpërndarjes së këtyre dokumenteve në asamblenë akademike dhe në faqen zyrtare elektronike të universitetit.

6. UK është institucion laik.

## **KREU II**

### **UNIVERSITETI I KORÇËS-STRUKTURA ORGANIZATIVE, TË DREJTA DHE DETYRIME**

#### **Neni 4**

##### **A. STRUKTURA ORGANIZATIVE (Universiteti)**

1. UK-ja është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese e profesionale dhe të transferimit të dijeve.

2. Struktura organizative e UK-së përcaktohet nga lloji i programeve të studimit dhe i shërbimeve që ofron, në përputhje me fushat parësore të studimit dhe kërkimit, me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me këtë statut dhe të gjitha aktet nënligjore.

3. UK-ja përfaqëson një strukturë të përbërë dhe të integruar, në mënyrë që të realizojë një arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të profesioneve, për të transmetuar njohuri

në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale, duke u bazuar në kërkim dhe njohuri teknologjike bashkëkohore.

4. UK-ja mbështet aftësimin e mëtejshëm të personelit akademik në funksion të realizimit të misionit të tij.

5. UK-ja ofron programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, programe studimi me karakter profesional, si dhe programe të formimit të vazhduar.

6. Në përputhje me misionin kryesor të përcaktuar në këtë statut, UK-ja siguron raportet e përshtatshme ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që ofron.

7. UK-ja, për të kryer veprimtari të arsimit dhe kërkimit me interes të përbashkët, ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione të tjera publike dhe private.

8. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në UK organizohet si më poshtë:

- Strukturat akademike në nivel institucioni janë :
  - Senati akademik;
  - Rektori;
  - Rektori;
  - Zëvendësrektori/ët.
  
- Strukturat akademike në nivel njësie kryesore janë :
  - Asambleja e personelit akademik;
  - Dekanati;
  - Dekani;
  - Zëvendësdekani/ët.
  
- Strukturat akademike në nivel njësie bazë janë :
  - Drejtuesi i departamentit;
  - Grupet mësimore/kërkimore shkencore
  
- Strukturat administrative në nivel institucioni janë :
  - Drejtoria Ekonomike
  - Drejtoria e Financës
  - Njësia e Auditimit të Brendshëm
  
- Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni janë :
  - Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor
  - Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit
  - Koordinator i projekteve Erasmus+
  - Qendra për formimin e vazhduar
  - Qendra rinore dhe sportive
  - Asistent i Rektorit
  
- Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore janë janë :
  - Njësia për sigurimin e cilësisë
  - Sekretaria mësimore
  - Biblioteka e Fakultetit
  - Asistent i Dekanit



- Strukturat ndihmësakademike me karakter akademik në nivel njësie bazë janë janë :
  - Laborantët
  - EDE- Ekonomia Didaktike Eksperimentale
- Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie bazë janë janë :
  - Sekretaritetë në departament.

9. Struktura akademike dhe administrative e UK-së paraqitet në anekset bashkëlidhur këtij Statuti në formën e organigramës. Veprimet e këtyre strukturave disiplinohen në rregulloret përkatëse të miratuara nga Senati Akademik apo Bordi i Administrimit.

## **Neni 5**

### **B. ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

#### **Njësitë kryesore**

1. Fakulteti është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore të përafërta ose të ndërthurura.
2. UK-ja përbëhet nga këto njësi kryesore:
  - Fakulteti i Bujqësisë
  - Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
  - Fakulteti i Ekonomisë
  - Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
3. Fakulteti organizohet në të paktën tri njësi bazë, të cilat grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.
4. Fusha specifike e secilës njësi bazë përcaktohet në rregulloren e fakultetit.
5. Autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore është dekani.
6. Autoriteti më i lartë administrativ i njësisë kryesore është administratori i saj.
7. Çdo njësi kryesore harton dhe zbaton rregulloren e saj.
8. Njësia kryesore miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësisë bazë, në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015 datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore.

## **Neni 6**

### **Njësitë bazë**

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore në UK, që përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
2. Autoriteti më i lartë akademik i njësisë bazë është drejtuesi i saj.
3. Njësia bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-botuese ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.

4. Njësia bazë përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Njësia bazë mund të ketë në përbërjen e saj edhe personel ndihmësimor.

5. Njësia bazë organizohet në grupe mësimore dhe grupe kërkimore, që përbëhen nga jo më pak se 5, personel akademik me kohë të plotë. Titullarët e grupeve duhet t'i përkasin kategorisë “Lektor” dhe përzgjidhen me konkurrim të hapur, të drejtuar nga një komision *ad hoc*, i ngritur nga titullari i njësisë kryesore me propozim të drejtuesit të njësisë bazë. Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni *ad hoc*, për një periudhë deri 4-vjeçare. Kriteret dhe procedurat e konkurrimin specifikohen në rregulloren e njësisë kryesore.

6. Njësia bazë propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore. Njësia bazë përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e saj.

7. Njësia bazë mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve përkatëse të rregulloreve të UK-së.

8. Njësitë kryesore (fakultetet) të UK-së përbëhen nga këto njësi bazë (departamente).

#### **Fakulteti i Bujqësisë**

- Departamenti i Agronomisë
- Departamenti i Agrobiznesit
- Departamenti i Agroushqimit

#### **Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë**

- Departamenti i Edukimit
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja me grupin mësimor të Gjuhësisë
- Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
- Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë

#### **Fakulteti i Ekonomisë**

- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Marketing-Turizmit
- Departamenti i Menaxhimit

#### **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane**

- Departamenti i Biologji-Kimisë
- Departamenti i Infermierisë
- Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës me grupin mësimor të Informatikës dhe Fizikës
- Departamenti i Shkencave Sociale

### **Neni 7**

#### **Strukturat ndihmësakademike**

Strukturat ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni janë :

1. **Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor**, e cila kujdeset:

- ✓ për hartimin, organizimin dhe zbatimin e programeve të reja të studimit dhe çështje që lidhen me zbatimin e detyrave të lëna nga ASCAL-i, si dhe për monitorimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës në cikle të ndryshme të studimit;

✓ për mbarëvajtjen e veprimtarive të përgjithshme kërkimore në institucion, mbikëqyrjen e procedurës së aplikimit dhe menaxhimit të projekteve kërkimore dhe hartimin e planit strategjik të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës kërkimore e botuese.

✓ për zhvillimin e veprimtarive të trajnimit dhe të kualifikimit në zhvillimin e kompetencave profesionale, në mënyrat dhe praktikat e zhvillimit profesional të specialistëve të fushave të ndryshme.

2. **Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit** e cila kujdeset:

✓ për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit; kryerjen e veprimeve për pranimin, evidencimin, shpërndarjen dhe nisjen e korrespondencës në UK; ruajtjen, përpunimin dhe vënien në shfrytëzim të dokumenteve të krijuara apo të ardhura në UK; kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, si dhe të Statutit, rregulloreve, dhe akteve të brendshme të universitetit gjatë zhvillimit të veprimtarisë së këtij institucioni;

✓ për marrëdhëniet me jashtë, si dhe marrëdhëniet brenda universitetit dhe me publikun ;

✓ për sigurimin, përpunimin, transferimin dhe mbarëvajtjen e informacionit, në bashkëpunim me strukturat e tjera në Rektorat, ministrinë përgjegjëse për arsimin, INSTAT-in dhe institucione të tjera jashtë UK-së, mbikëqyrjen e shkëmbimit të informatizuar të të dhënave ndërmjet Universitetit dhe institucioneve të tjera jashtë tij, si dhe për hartimin e projektdokumentacionit për emërtimet e diplomave për të gjitha ciklet e studimit.

3. Koordinator i projekteve Erasmus+, i cili përbën një qendër reference për të gjithë aplikantët, përfituesit dhe të gjithë të interesuarit e tjerë në lidhje me veprimtaritë e programit Erasmus+ në fushën e arsimit të lartë. Koordinatori luan një rol të rëndësishëm në promovimin dhe këshillimin për aplikime në Erasmus+, jep asistencë teknike për përgatitjen e projekteve, gjetjen e partnerëve dhe aspekte të tjera kyçe për projekte të suksesshme. Gjithashtu ai është përgjegjës për monitorimi e projekteve që zbatohen në UK.

4. Qendra për formimin e vazhduar organizon trajnime të specialistëve sipas fushave që ofrojnë fakultetet.

5. Qendra rinore dhe sportive e Universitetit është në shërbim të studentëve për të nxitur, vlerësuar dhe promovuar aftësitë e tyre në fusha të ndryshme si: arti, kultura, sporti etj.

6. Asistenti i Rektorit, i cili ndihmon në realizimin e detyrave të titullarit.

7. Funksionimi dhe administrimi strukturave ndihmëse përcaktohet në rregullore të veçanta.

## Neni 8

### Strukturat administrative

1. Në funksion të plotësisht të nevojave të njëjësive mësimore-shkencore e detyrimeve legale dhe fiskale, në UK funksionojnë si **strukturat administrative**:

- **Drejtoria Ekonomike**, e cila kryen administrimin në mënyrë të vazhdueshme të procesit të prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet, si dhe menaxhon nevojat për transport dhe mirëmbajtje që ka UK-ja.

- **Drejtoria e Financës**, e cila ndjek :

✓ të gjithë veprimet financiare që lidhen me shpenzimet për veprimtarinë e UK-së, pagesat e personelit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe

Promocionit, të shpenzimeve operative dhe investimeve në bashkëpunim me njësitë e tjera, si dhe bën mbylljen e bilancit vjetor për gjithë universitetin.

- ✓ zbatimin e të gjithë procedurave financiare të realizimit të buxhetit të universitetit, të buxheteve të tjera (shërbime, donacione, projekte), mbajtjen e dokumentacionit përkatës në lidhje të ngushtë me organizmat financiare shtetërore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore.

- **Njësia e auditimit të brendshëm**, e cila zbaton politikën dhe strategjinë e Universitetit për zhvillimin e vazhdueshëm të auditimit në arritjen e standardeve.

2. Veprimtaria e këtyre njësive disiplinohet me rregulloret përkatëse të miratuara nga Bordi i Administrimit i UK-së.

### **KREU III**

#### **UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” – ORGANIZIMI DHE DREJTIMI AKADEMIK**

##### **Neni 9**

##### **Organet Kolegjiale dhe Autoritetet Drejtuese**

1. Organi më i lartë drejtues akademik i UK-së është Senati Akademik.
2. Organe të tjera akademike janë: Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme.
3. Autoritetet drejtuese akademike janë: rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë.
4. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.
5. Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i UK-së, si dhe administratori i njësisë kryesore.
6. Organe kolegjiale të tjera janë: Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.
7. UK-ja gëzon të drejtën të krijojë në strukturën e vet edhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e saj, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe në këtë Statut.
8. Anëtarët e Senatit Akademik dhe autoritetet drejtuese akademike zgjidhen përmes një procesi të përgjithshëm zgjedhor, i cili zhvillohet çdo katër vjet.
9. Anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”. Autoritetet administrative përzgjidhen në përputhje me përcaktimet e po këtij ligji.

##### **Neni 10**

##### **Senati Akademik**

1. Senati Akademik është organi më i lartë kolegjial vendimmarrës i UK-së, i cili përcakton politikën e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

2. Kryetar i Senatit Akademik është rektori. Senati Akademik mbledhet në mënyrë periodike.

3. Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së zgjidhen nga asamblatë e personelit akademik të njësive kryesore, me votim të përgjithshëm për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje mes anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të vetëkandiduar.

4. Anëtarët e Senatit Akademik të UK-së i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose

BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria mund të zbrësë edhe në “lektor” me gradën shkencore “Doktor”.

5. Në Senatin Akademik të UK-së bëjnë pjesë dhe studentë në masën dhjetë për qind të numrit të anëtarëve të Senatit.

6. Senati Akademik përbëhet nga 19 anëtarë, të ndarë sipas skemës në vijim :

- Rektori i zgjedhur, i cili drejton Senatin Akademik sipas përcaktimeve të nenit 39, pika 4, të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” ;

- Katër përfaqësues nga secila njësi kryesore, të zgjedhur nga asambleja e personelit akademik e këtyre njësive, sipas përcaktimeve të nenit 37, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” ;

- Dy përfaqësues të studentëve, të zgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”

7. Senati Akademik mbledhet në seanca të zakonshme, të paktën një herë në dy muaj. Seancat e jashtëzakonshme thirren kur rektori ose 1/3 e anëtarëve të tij e kërkojnë një gjë të tillë.

8. Mbledhjet e Senatit Akademik të UK-së zhvillohen konform Rregullores së funksionimit të tij, që miratohet nga vetë Senati Akademik.

9. Mbledhjet e Senatit Akademik zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet e tij merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve të miratimit të çështjeve të veçanta, të përcaktuara në ligj, akte nënligjore apo akte të brendshme të institucionit, për të cilat duhet të merren vendime me shumicë të cilësuar. Në këto raste mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën aq anëtarë, sa është numri i votave që kërkohen për miratimin e vendimeve për këto çështje.

## **Neni 11**

### **Funksionet e Senatit Akademik**

Në bazë të nenit 38 të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.05.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, funksionet e Senatit Akademik përcaktohen si më poshtë vijon:

1. Senati Akademik vendos për çështje të rëndësishme të Universitetit në fushën e mësimin, kërkimit shkencor, administrativ, si dhe financiar, pasi merr miratimin e Bordit të Administrimit sipas përcaktimeve të ligjit.

2. Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe të mundësive të barabarta, të lirisë akademike, të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve.

3. Propozon planin strategjik të zhvillimit të UK-së.

4. Miraton Statutin e UK-së me 2/3 e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit.

5. Harton strukturën e përgjithshme të UK-së dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të UK-së në të gjitha nivelet.

6. Miraton rregulloret e universitetit që janë kompetencë e tij, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe në këtë statut.

7. Senati Akademik është përgjegjës për ruajtjen e interesave themelore të UK-së dhe ndërhyrjen në aktet e brendshme të njësive kryesore, kur ato bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe interesat e universitetit.

8. Senati Akademik kërkon mendimin e Bordit të Administrimit për probleme që janë në kompetencë të këtij të fundit.

9. Miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet, si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të UK-së.

10. Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të UK-së, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit.

11. Propozon riorganizimin e UK-së, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë.

12. Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të UK-së.

13. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UK-së, të hartuar nga Rektori dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

14. Zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit.

15. Miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të UK-së.

16. Krijon komisionin e përhershëm për promovimin e personelit akademik, për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, kur UK-ja plotëson kriteret ligjore, si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në këtë Statut.

17. Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UK nëpërmjet mekanizmave përkatës.

18. Krijon mekanizmat për matjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik, sipas standardeve shtetërore të sigurimit të cilësisë.

19. Miraton hapjen e degëve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga njësitë kryesore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, pas marrjes së vlerësimit paraprak nga Bordi i Administrimit.

20. Miraton kriteret e pranimit për të gjitha programet dhe ciklet e studimeve, si dhe kuotat përkatëse, sipas propozimeve të njësive bazë dhe njësive kryesore, dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin.

21. Miraton vendosjen e marrëdhënieve në nivel kombëtar e ndërkombëtar të propozuar nga njësitë kryesore.

22. Bazuar në propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik vendos për dhënien e titujve dhe vlerësimeve të tjera të përcaktuara në nenin 38 të këtij statuti.

23. Organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dheveprimtarinë financiare.

24. Përmes një procesi vetëkandidimi dhe/ose propozimeve të sjella nga vetë Senati, Senati Akademik zgjedh me shumicë të thjeshtë votash anëtarët e Këshillit të Etikës dhe të Komisioneve të Përhershme. Në përbërje të komisioneve caktohet personel akademik, anëtarë ose jo, të Senatit Akademik, si dhe përfaqësues nga studentët, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe këtij statuti.

25. Senati Akademik vendos për publikimin ose jo të vendimeve të marra prej tij. Ky publikim bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.

## **Neni 12**

### **Mbarimi i mandatit të anëtarit të Senatit Akademik**

1. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik është me kohëzgjatje 4-vjeçare. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik mbaron para kohe në rastet:
  - e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - e shkeljeve të rënda të ligjit;
  - e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në Senat;
  - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - kur jep dorëheqjen;
  - në raste paaftësie fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - me mungesën pa arsye në 3 (tre) seanca radhazi;
  - kur largohet nga universiteti.
2. Zëvendësimi i anëtarit të larguar bëhet me anë të zgjedhjeve të reja brenda një muaji në njësinë që përfaqëson anëtari i larguar.

## **Neni 13**

### **Rektori**

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i UK-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët e UK-së, ka titullin “Profesor” dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës.
3. Drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.
4. I paraqet Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të UK-së.
5. Është anëtar i Konferencës së Rektorëve të universiteteve shqiptare.
6. Ka të drejtën të informohet nga autoritetet drejtuese të të gjitha njësive për vendimet dhe masat e marra prej tyre.
7. Shfuqizon kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit aktet e dekanit, kur ato bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së.
8. Lëshon /konfirmon, përkundrajt firmës, diplomat e përfundimit të studimeve universitare dhe pasuniversitare, pa patur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
9. Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmësakademik.
10. Jep lehtë për hyrjen e organeve të rendit publik në territorin dhe mjediset e universitetit dhe mund t’i thërrasë ato në rast nevojë.
11. Ka të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë, vartës të tij. Në rast mungese, i delegon kompetencat, ose një pjesë të tyre, zëvendësrektorëve.
12. Ngre komisione e grupe për çështje, studime e veprimtari të veçanta.
13. Emëron dekanët e njësive kryesore, zëvendësrektorët, drejtorët e drejtorive, si dhe përgjegjësit e sektorëve dhe zyrave.
14. Zgjidh në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjet mes dekanit dhe përgjegjësit të njësisë bazë apo dhe mes dy dekanëve.
15. Miraton masën disiplinore të përjashtimit të studentëve nga universiteti për rastet e parashikuara në rregulloret e fakulteteve dhe Kodin e Etikës.
16. I kërkon informacion Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi.
17. Jep dhe miraton masat disiplinore për punonjësit deri në largimin e tyre nga puna, kur shkelen dispozitat e Kodit të Punës, Statutit dhe Kodit të Etikës të UK-së.
18. Nënshkruan promocionet, dekorimet apo shpërblimet e punonjësve të UK-së në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe këtë statut;

19. Nënshkruan marrëveshje në emër të UK-së dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi në fushën akademike me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj brenda dhe jashtë vendit, pas miratimit paraprak nga Senati Akademik dhe/ose Bordi i Administrimit.

20. Ka detyrimin që të koordinojë veprimtaritë mes UK-së, njërive kryesore dhe njërive bazë.

21. Referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UK-së, rektori i propozon ministrit përgjegjës për arsimin, shkarkimin e dekanit. Në një situatë të tillë, rektori cakton njërin prej zëvendësdekanëve në detyrën e dekanit, deri në zgjedhjen e autoritetit të ri brenda dy muajve nga data e shkarkimit. Brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme.

22. Mandati i rektorit zgjat katër vjet dhe shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

23. Mandati i rektorit të zgjedhur mbaron para kohe në rastet:

- a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- b) kur jep dorëheqjen;
- c) e pamundësisë për të kryer detyrën;
- ç) e shkeljeve të rënda të ligjit;
- d) kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
- dh) kur largohet nga institucioni.

24. Referuar Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UK-së, ministri pezullon rektorin dhe i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Në rast se Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda këtij afati, propozimi i ministrit konsiderohet i miratuar në heshtje. Pas dekretimit të shkarkimit, ministri shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

#### **Neni 14** **Zëvendësrektori/ët**

1. Numri i zëvendësrektorëve në UK është dy :
  - a. Zëvendësrektori për mësimin
  - b. Zëvendësrektori për shkencën dhe projektet
2. Zëvendësrektorët emërohen nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij nga Senati Akademik. Shkarkimi i tyre bëhet nga Rektori pas miratimit nga Senati Akademik.
3. Zëvendësrektorët duhet të mbajnë titullin akademik që i përket kategorisë “Profesor”, ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.
4. Zëvendësrektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë.
5. Zëvendësrektorët kryejnë detyrat e përcaktuara në urdhrin e Rektorit, si dhe në mungesë dhe me porosi të tij, nënshkruajnë aktet përkatëse.
6. Marrëdhëniet e zëvendësrektorëve me organet e tjera në Rektorat dhe në të gjithë universitetin përcaktohen në Rregulloren e UK-së



## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë dhe kompetencat e zëvendësrektorëve**

**A. Zëvendësrektori për mësimin** ka këto detyra dhe kompetenca:

1. Organizon dhe kontrollon punën mësimore në nivel universiteti (UK).
2. Ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore për dy ciklet e studimit (Bachelor, Master i Shkencave, Master Profesional,) në njësitë kryesore dhe njësitë bazë.
3. Harton strukturën e vitit akademik për procesin mësimor në shkallë universiteti dhe ia paraqet Rektorit për miratim.
4. Në bashkëpunim me njësitë kryesore të universitetit, i paraqet Rektoratit kuotat dhe kriteret e pranimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.
5. Kontrollon dhe përgjithëson përvojën mësimore të njësive bazë/ kryesore të UK-së gjatë procesit mësimor.
6. Përgatit, në bashkëpunim me strukturat ndihmëse, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore të universitetit dhe ia paraqet për miratim Rektoratit.

**B. Zëvendësrektori për shkencën dhe projektet** ka këto detyra dhe kompetenca:

1. Ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës shkencore dhe projekteve në nivel universiteti (UK).
2. Ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të programeve mësimore për ciklin e tretë të studimeve (studime doktorate) në njësitë kryesore dhe njësitë bazë.
3. Kontrollon punën për specializimet pasuniversitare afatgjata brenda dhe jashtë shtetit të punonjësve mësimorë-shkencorë të UK-së.
4. Ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të UK-së me institucione kërkimore-shkencore, universitete të tjera (brenda dhe jashtë vendit), firma, ndërmarrje prodhimi etj.
5. Organizon dhe harmonizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të Universitetit "Fan S. Noli" në fushën e kërkimit dhe ia paraqet Rektorit.
6. I paraqet Rektorit projektet e mundshme lidhur me punën shkencore.
7. Në bashkëpunim me strukturat ndihmëse, përgatit raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore të universitetit dhe ia paraqet Senatit Akademik për miratim.

## **Neni 16**

### **Largimi nga detyra i zëvendësrektorëve**

Zëvendësrektorët largohen nga detyra në rastet:

1. kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
2. kur japin dorëheqjen;
3. e pamundësisë për të kryer detyrën;
4. e shkeljeve të rënda të ligjit;
5. kur bëhen të paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
6. kur largohen nga universiteti.

## **Neni 17**

### **Rektorati**

1. Rektorati është organi kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
  - Rektori ;
  - Zëvendësrektorët ;
  - Administratori i UK-së ;

- Dekanët e njësive kryesore;
- 2. Funkcionet e Rektoratit janë:
  - Harton planin strategjik të zhvillimit të UK-së, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe njësive kryesore të universitetit, si dhe ato të administratorëve.
  - Harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatit Akademik;
  - Harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, brenda muajit janar të vitit pasardhës.
  - Harton planin për bashkëpunimet dhe marrëveshjet që janë kompetencë e tij dhe ia paraqet për miratim Senatit Akademik;
  - I paraqet Senatit Akademik dhe/ose Bordit të Administrimit rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre, sipas propozimeve të njësive bazë;
  - Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit;
  - Monitoron veprimtarinë e UK-së dhe publikon rezultatet e vlerësimit të tij;
  - Përgatit dhe miraton rregulloren e tij të punës.
  - Vë në dispozicion infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e veprimtarisë së universitetit dhe organeve të tij.
  - Realizon kontrole periodike në njësitë e universitetit për përmbushjen e objektivave të parapara, si dhe për zbatimin e akteve dhe legjislacionit në fuqi.
- 3. Marrëdhëniet e Rektoratit me organet e tjera të universitetit, si dhe detyrat e tjera përcaktohen në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.

### **Neni 18** **Dekani**

1. Dekani është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi i njësisë kryesore,
2. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose dhe jashtë tij.
3. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe studentët dhe emërohet nga rektori i UK-së.
4. Mandati i dekanit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
5. Dekani koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis tyre.
6. Organizon dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës, si dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga njësitë bazë apo personeli i njësisë që ai drejton.
7. Miraton rregulloret e brendshme të njësive bazë në përbërje të njësisë kryesore.
8. Firmos diplomat e përfundimit të studimeve universitare dhe pasuniversitare, pa patur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
9. Emëron përgjegjësit e zgjedhur të njësive bazë.
10. Emëron dhe shkarkon zëvendësdekanët e njësisë kryesore, pasi merr miratimin e Dekanatit.
11. Emëron tiullarët e grupeve mësimore e kërkimore.
12. I propozon rektorit për punësimin e personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, pas propozimeve të bëra nga njësitë bazë.
13. I propozon rektorit për emërimin e personelit akademik të ftuar, që janë shpallur fitues nga komisionet e njësive bazë.

14. Miraton anëtarët dhe kryetarët e komisioneve të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave dhe tezat e provimeve të formimit.

15. I propozon rektorit masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirim nga detyra dhe ndaj studentëve deri në përjashtimin nga institucioni.

16. Ka të drejtën të informohet nga të gjitha njësitë e fakultetit për vendimet dhe masat e marra nga to. Në rastin kur këto vendime janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin dhe rregulloret e UK-së apo njësisë kryesore, si dhe me aktet e brendshme të institucionit, ai ka detyrimin të informojë rektorin.

17. I propozon asamblesë akademike hapjen, mbylljen, reformimin e kurrikulave, të departamenteve apo të njësive të veçanta në fakultet.

18. Dekani i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij.

19. Dekani i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive bazë në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës. Zëvendësuesi i drejtuesit të njësive bazë caktohet nga rektori, me propozim të drejtuesit të njësive kryesore. Rektori shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

20. Nënshkruan marrëveshjet që njësia kryesore lidh me të tretë, vetëm pasi të marrë miratimin nga Senati Akademik.

21. I propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësive kryesore.

22. Dekani, gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, shprehet me anë të urdhrave dhe udhëzimeve, të cilat bëhen publike bazuar në Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr.119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”.

23. Mandati i dekanit të zgjedhur mbaron para kohe në rastet:

- kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- kur jep dorëheqjen;
- e pamundësisë për të kryer detyrën;
- e shkeljeve të rënda të ligjit;
- kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
- kur largohet nga Universiteti.

24. Referuar Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së UK-së, rektori i propozon ministrit përgjegjës për arsimin shkarkimin e dekanit. Ministri shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri brenda dy muajve nga data e shkarkimit. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.

## **Neni 19** **Zëvendësdekani**

1. Zëvendësdekani, si anëtar i dekanatit:
  - a. është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i emëruar nga dekani pas miratimit të kandidataturave të propozuara prej tij në dekanat.
  - b. Ai shkarkohet nga dekani në rastet :
    - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

- kur jep dorëheqjen;
  - e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - e shkeljeve të rënda të ligjit;
  - kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - kur largohet nga universiteti.
- c. Zëvendësdekani është autoriteti drejtues që merret me anën mësimore-shkencore në njësinë kryesore dhe, në mungesë të dekanit, edhe me detyra të tjera të autorizuara prej tij.

## **Neni 20 Dekanati**

2. Dekanati drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
  - a. dekani
  - b. zëvendësdekani
  - c. administratori i njësisë kryesore
  - d. drejtuesit e njësive bazë.
3. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij, si dhe ato të administratorit të saj.
4. Dekanati koordinon veprimtaritë e njësive bazë të fakultetit.
5. Marrëdhëniet mes anëtarëve në dekanat përcaktohen në Rregulloren e brendshme të njësisë kryesore
6. Dekanati shqyrton vendimet e njësive bazë për hapjen, ndryshimin dhe mbylljen e programeve të reja të studimit dhe ia propozon Senatit Akademik për veprime të mëtejshme.
7. Ai shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të njësisë kryesore.
8. Ai i përcjell Rektoratit planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore dhe mbikëqyr realizimin e tij;
9. Miraton rregulloren e njësive kryesore;
10. Miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë njësia kryesore përkatëse me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani, vetëm pasi të marrë miratimin e Senatit Akademik.
11. I përcjell për miratim Senatit Akademik propozimet e njësive bazë për dhënien e titujve dhe vlerësimeve të tjera të përcaktuara në nenin 38 të këtij Statuti.
12. Njësia kryesore ka në strukturën e saj një zëvendësdekan.

**Neni 28**  
**Mbarimi i parakohshëm i mandatit të anëtarit të Bordit të Administrimit**

1. Mandati i anëtarit të Bordit të Administrimit mbaron para kohe në rastet :
  - e ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në Bordin e Administrimit;
  - e pamundësisë për të kryer detyrën;

- e shkeljeve të rënda të ligjit;
  - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - e paaftësisë fizike apo mendore për të ushtruar funksionin;
  - e mungesës pa arsye në 3 (tre) seanca radhazi;
  - kur largohet nga universiteti;
  - kur anëtari i Bordit të Administrimit jep dorëheqjen.
2. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin, me propozimin e organit që i zgjedh apo emëron.
3. Propozimi për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të UK-së, bëhet në rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, nga Senati Akademik.

## **Neni 29**

### **Përzgjedhja dhe statusi i Administratorit të UK-së**

1. Administratori i UK-së është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të universitetit. Ai është përfaqësues ligjor i universitetit për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”.

2. Administratori përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

3. Përzgjedhja e administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve.

4. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ.

5. Administratori i UK-së shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

6. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik dy herë në vit.

7. Marrëdhëniet e administratorit me Rektoratin dhe organet e tjera në universitet, si dhe detyrat e tjera që mund t’i delegohen, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.

## **Neni 30**

### **Funksionet e Administratorit të UK-së**

Administratori i UK-së kryen këto funksione:

1. Harton planin buxhetor afatmesëm të UK-së.
2. Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore dhe të njëjësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të universitetit, si dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij.
3. Propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen dhe zbatimin e tyre.
4. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të universitetit në strukturat e varësisë së tij.
5. Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Bordit të Administrimit.

6. Zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ.
7. I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të universitetit në përfundim të vitit akademik.
8. Plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
9. Bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të universitetit për çështje të administrimit të përditshëm.
10. Emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë, pas miratimit të Bordit të Administrimit.
11. Thërret për raportim administratorët e njësive kryesore dhe përgjegjësit e strukturave administrative që ka në varësi.
12. Organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të UK-së.
13. Organizon dhe drejton kryerjen e veprimtarive për shërbimet ndaj të tretëve.
14. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit dhe ankandeve që zhvillon institucioni, përkatësisht sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimet dhe ankandet, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
15. Është përgjegjës direkt për performancën administrative dhe financiare të UK-së dhe/ose njësive të tjera të tij, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

### **Neni 31**

#### **Përzgjedhja dhe statusi i Administratorit të Njesisë Kryesore**

1. Administratori i njësisë kryesore është përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj. Ai zgjidhet me konkurs, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit.
2. Administratori i njësisë kryesore duhet të ketë formim universitar, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet në këto fusha. Ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
3. Administratori i njësisë kryesore emërohet dhe shkarkohet nga administratori i UK-së, pas miratimit të Bordit të Administrimit.
4. Administratori i njësisë kryesore i raporton për veprimtarinë e tij administratorit të universitetit, si dhe informon dekanin, sipas përcaktimeve në aktet e universitetit.

### **Neni 32**

#### **Funksionet e Administratorit të Njesisë Kryesore**

1. Organizon punën dhe është përgjegjës për hartimin e projektbuxhetit për njësinë kryesore dhe njësitë bazë.
2. Është përgjegjës për drejtimin administrativ dhe financiar të njësisë kryesore, për zbatimin e buxhetit, mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë.
3. Realizon administrimin e përditshëm financiar të njësisë kryesore.
4. Mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë financiare të njësisë kryesore.
5. Plotëson kërkesat e drejtuesit të njësisë kryesore, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
6. Bashkëpunon me autoritetet dhe organet drejtuese të njësisë kryesore për çështjet themelore të administrimit të saj.

7. Organizon e kontrollon veprimtarinë ekonomiko-administrative në njësinë kryesore dhe ndjek zbatimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.

8. Drejton punën për pajisjen me bazë materiale mësimore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, sipas planit të miratuar.

9. Organizon kryerjen e studimeve për zgjerimin, rinovimin dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe mjediseve të njësisë kryesore dhe ia paraqet Dekanit.

10. Organizon, kontrollon dhe ndjek gjendjen e mjediseve të njësisë kryesore, dhe kur është e nevojshme, bën menjëherë kërkesë tek Administratori i UK-së për përmirësimin e gjendjes.

11. Ndjek sigurimin e bazës materiale e didaktike sipas kërkesave të njësisë bazë, që u nevojiten për procesin mësimor dhe kërkimor, brenda planit të miratuar të shpërndarjes.

12. Ndjek përgatitjen e dokumentacionit për lëvizjet e inventarit në përdorim.

13. Ndjek punën e shërbimit të ruajtjes së jashtme të ndërtesave të njësisë kryesore.

14. Ndjek furnizimin me energji elektrike dhe ujë dhe kryen kontrole periodike në bashkëpunim me strukturat përkatëse në UK.

## **KREU V**

### **UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” - PERSONELI AKADEMIK, NDIHMËS AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV**

#### **Neni 33**

##### **Të përgjithshme**

1. Personeli në UK përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-akademik dhe personeli administrativ.

2. Personeli në UK është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, sipas Rregullores së UK-së për lidhjen e kontratave me punonjësit.

3. Ata zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, Rregulloret e universitetit dhe të njësisë kryesore, dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së.

4. Të drejtat dhe detyrimet e personelit në UK-së përcaktohen në këtë Statut, në rregulloret e akte të tjera të brendshme të universitetit dhe/apo njësisë kryesore, si dhe në kontratat individuale të punës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### **Neni 34**

##### **Statusi dhe trajtimi i veçantë i personelit akademik**

1. Personeli akademik në UK gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.

2. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:

- mësimdhënie;
- punë kërkimore-shkencore;
- kontribut institucional;
- kontribut profesional.

3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe nuk presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik.



Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

4. Personeli akademik e humbet statusin kur përfundon/zgjidhet kontrata.

5. Anëtarët e personelit akademik nuk mund të penalizohen nga insitucioni për shkak të rezultateve të vlerësimit të punës së tyre kërkimore-shkencore, të kryera në përputhje me fushën përkatëse dhe misionin e UK-së.

6. Në rast se anëtari i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim joetik ndaj tij, i drejtohet Këshillit të Etikës së UK-së, për këtë çështje. Procedura e trajtimit të ankesave kryhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të UK-së. Vendimi i Këshillit të Etikës është gjithnjë i ankimueshëm në rrugë gjyqësore.

7. Anëtarët e personelit akademik të kategorive “Profesor” dhe “Lektorë”, punësohen në UK nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Asistentë-lektorë”, punësohen në UK nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të caktuar. Të tria këto kategori mund të punësohen me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme.

8. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të UK-së.

9. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1 536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e përgjegjësit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

11. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e UK-së.

12. Personeli akademik, për veprimtaritë që lidhen me drejtimit e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij neni, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga dekani, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara njësisë bazë mbi veprimtariin e kryer gjatë lejes.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e UK-së. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.

14. Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit.

15. Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/ titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.

16. Personeli akademik përfiton kompensim e rimbursim financiar, kur punon për veprimtaritë e parashikuara në drejtimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në masën dhe sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe kuadrit ligjor në fuqi.

17. Personeli akademik mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, për arsye shëndetësore apo familjare. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

18. Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik që burojnë nga aktet nënligjore në fuqi pasqyrohen dhe në kontratën individuale të punës.

### **Neni 35**

#### **Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik**

1. Personeli akademik i UK-së ka këto të drejta:
  - Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
  - Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;
  - Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e UK-së, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të institucionit.
2. Personeli akademik i UK-së ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
  - Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, sipas orarit të punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës;
  - Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;
  - Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të UK-së;
  - Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në UK;
  - Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit dhe figurës profesionale.
  - Të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje, gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike.

### **Neni 36**

#### **Kategoritë e personelit akademik**

1. Personeli akademik në UK kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të UK-së, këshillim për studentët, konsulencë e trajnime për të tretët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik në UK është me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Njësitë bazë dhe njësitë kryesore kanë detyrimin që të bëjnë këtë klasifikim për UK-në dhe ta rinovojnë atë në mënyrë periodike.
3. Personeli akademik në UK, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
  - Profesorë;
  - Lektorë;
  - Asistent-lektorë.

4. Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

5. Në kategorinë “Lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, kanë së paku tre vjet përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin e UK-së. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.

6. Në kategorinë “Asistent-lektorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën “Master i shkencave” dhe të përmbushin kriteret e përcaktuara në Statutin e UK-së. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.

7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

8. Raportet midis veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen nga UK-ja.

9. Personeli akademik në UK punon në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Kodin e Punës, Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, akte të tjera ligjore e nënligjore, statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së, si dhe në kontratën e punës.

10. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga UK-ja, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

### **Neni 37**

#### **Titujt dhe vlerësimet e tjera**

1. Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, si dhe në VKM-në përkatëse, UK-ja jep përkatësisht titujt e mëposhtëm :

- **Doctor Honoris Causa**

- **Profesor Emeritus**

2. Kriteret dhe procedurat për dhënien e titujve përcaktohen me rregullore të veçantë.

3. Me vendim të Senatit Akademik, UK-ja jep vlerësimet e mëposhtme :

- **Diploma** e shoqëruar me medaljen e artë ;

- **Çmimi “Fan S. Noli”** i shoqëruar me medaljen e argjendtë.

### **Neni 38**

#### **Personeli akademik i ftuar**

1. Njësia bazë ka të drejtë të kërkojë të punësohen me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj. Personeli i ftuar përbëhet nga punonjës me tituj shkencorë.

2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet nga njësia kryesore mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, pasi të jenë identifikuar modulet ku do të angazhohen, vëllimi i orëve mësimore (leksione/ seminare, laboratore etj.) që ata do të kryejnë, si dhe kualifikimi i kandidatëve.

3. Kontrata e punës e personelit akademik të ftuar bëhet nga rektori i UK-së.

4. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e universitetit.

### **Neni 39** **Viti akademik sabatik**

1. Personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Kjo periudhë mund të përdoret si e tërë ose me pjesë.
3. Rregullimi i marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve për këtë periudhë bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje në të cilën përcaktohen:
  - Kohëzgjatja e lejes sabatike
  - Objekti i lejes sabatike

### **Neni 40** **Punësimi i personelit akademik**

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori.
2. Konkursi i pranimit të personelit akademik në UK drejtohet nga një komision *ad hoc* (i posaçëm), i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse.
3. Dekani i njësisë kryesore i kërkon rektorit ngritjen e komisionit *ad hoc*, bazuar në kërkesën e njësisë bazë për personel akademik. Rektori vendos formimin e komisionit *ad hoc*, i cili duhet të ketë në përbërje të tij 5 anëtarë, si më poshtë vijon:
  - Përgjegjësi i njësisë bazë **Kryetar**
  - Personel akademik i fushës përkatëse, i njësisë bazë **Anëtar**
  - Personel akademik i fushës përkatëse, i njësisë bazë **Anëtar**
  - Zëvendësrektori **Anëtar**
  - Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit **Anëtar**
4. Për vendet e lira konkurrimi shpallet, duke publikuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga rektori.
5. Procedurat e konkurrimit i kryen njësia bazë përkatëse.
6. Kontratat e punës nënshkruhen nga rektori, me cilësinë e punëdhënësit, si përfaqësues i UK-së.
7. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UK nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.
8. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UK mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me:
  - marrëveshje mes dy institucioneve
  - miratimin e drejtuesit të njësisë bazë
  - miratimin e rektorit.

### **Neni 41** **Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik**

1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor”, shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme ose jo.

2. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor i asociuar”, shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme ose jo.

3. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga universiteti, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t’u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtari i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.

## **Neni 42**

### **Masat disiplinore për personelin akademik**

1. Llojet e masave disiplinore janë :
  - Tërheqje vëmendjeje
  - Vërejtje me shkrim
  - Vërejtje me paralajmërim
  - Pezullim nga detyra
  - Largim nga detyra
2. Masat disiplinore jepen nga autoritetet drejtuese akademike, me përjashtim të largimit nga detyra që është kompetencë vetëm e rektorit.
3. Largimi nga detyra i personelit akademik të UK-së bëhet nga rektori, me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë, ku personeli akademik zhvillon veprimtarinë e tij dhe, pas miratimit të komisionit ad hoc, të ngritur nga Senati Akademik, në rastet e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit.
4. Në shkelje të rënda të ligjit përfshihen :
  - Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe/apo aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.
  - Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - Veprimet apo mosveprimet, e përsëritura, në kundërshtim me akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të detyrueshme për zbatim gjatë kryerjes së detyrës.
  - Kryerja e një vepre penale, për të cilën dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Rastet e tjera të shkeljeve, lloji i masës disiplinore për secilën shkelje dhe organi që i jep ato, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

## **Neni 43**

### **Personeli ndihmësakademik**

1. Personeli ndihmësakademik në UK ndahet në:
  - a. personel ndihmësakademik me karakter mësimor (laborantët dhe teknikët TI)
  - b. personel ndihmësakademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor:
  - a. ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor.
  - b. është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit.

3. Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bën pjesë personeli i njësive ndihmëse në funksion të procesit mësimor.

4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmësakademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga një komision *ad hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit *ad hoc*, si edhe të përzgjedhjes së personelit ndihmësakademik caktohen në Rregulloren e UK-së dhe/apo në Rregulloren e njësive kryesore përkatëse.

5. Të drejtat dhe detyrimet e personelit ndihmësakademik, përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe / apo në Rregulloren e njësive kryesore përkatëse, si dhe në kontratën individuale të punës.

#### **Neni 44** **Personeli administrativ**

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit, sipas legjislacionit në fuqi.

1. Punësimi i personelit administrativ bëhet me konkurs publik. Kriteret e përgjithshme të punësimit janë si vijon :

- të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
- të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurren.
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerje të veprës/ave penale.
- të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna (në rastin kur ka qenë i punësuar më parë).

Kriteret e veçanta dhe procedura e punësimit përcaktohen nga Bordi i Administrimit, mbështetur në statutin dhe aktet e tjera të UK-së.

2. Procedurat e vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, si edhe procedurat për masat disiplinore përcaktohen në Rregulloren e UK-së.

3. Të drejtat dhe detyrimet e personelit administrativ, përcaktohen në Rregulloren përkatëse të njësive ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative, si dhe në kontratën individuale të punës, që nënshkruhet nga Administratori i UK-së.

#### **Neni 45** **Zgjidhja e kontratës së punës**

1. Zgjidhja e kontratës së punës së personelit të UK-së bëhet në rastet e mëposhtme:
  - kur jep dorëheqjen.
  - kur bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën.
  - e pamundësisë për të kryer detyrën.
  - kur largohet nga universiteti.
  - Kur mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe/apo akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
  - Kur merr masën disiplinore të largimit nga detyra.
  - Kur përfundon koha e parashikuar, në rastet e kontratave me afat të caktuar, sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin

Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Nëse lindin mosmarrëveshje gjatë apo në përfundim të detyrës mes punëmarrësit dhe punëdhënësit, palët mund t’i drejtohen gjykatës kompetente, nëse ato nuk zgjidhen me mirëkuptim.

## **KREU VI PROGRAMET E STUDIMIT DHE ORGANIZIMI I TYRE**

### **Neni 46 Format e studimeve dhe pranimi i studentëve**

1. Format e studimeve në UK janë:
  - studime me kohë të plotë;
  - studime me kohë të zgjatur.
2. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në:
  - Programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional pas arsimit të mesëm;
    - Programet e ciklit të dytë “master profesional” ;
3. Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.
4. Pranimet e studentëve në UK në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore. Këto standarde verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, përpara deklaratimit të kuotave të pranimit nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

### **Neni 47 Programet e studimit në UK**

1. Programet e studimit organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS).
2. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.
3. Programet e studimit në UK hartohen nga njësitë bazë dhe i paraqiten për miratim Senatit Akademik.
4. Programet e studimit në UK janë të organizuara në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
5. UK ofron dhe diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
6. UK-ja shpall publikisht programet e studimit që ofron para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.
7. Çdo program studimi ka strukturën dhe përmbajtjen e tij, të cilat hartohen në përputhje me standardet e parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në respektim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.

### **Neni 48 Programet e studimit me karakter profesional**

1. UK-ja mund të ofrojë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer.

2. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale me karakter profesional, mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

#### **Neni 49**

#### **Programet e Ciklit të Parë të Studimeve**

1. Programet e ciklit të parë të studimeve, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.

3. Në rregulloren e studimeve të UK-së është i përcaktuar pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.

4. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

#### **Neni 50**

#### **Pranimi në Ciklin e Parë të Studimeve**

1. Pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë në UK, bëhet sipas kuotave të paracaktuara dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:

- Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, si dhe gruplëndët, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK) sipas përcaktimeve të njëjësive bazë.

#### **Neni 51**

#### **Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve**

1. Cikli i dytë i studimeve në UK përfshin programet e studimit “Master i shkencave” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Programet e studimit “**Master i shkencave**” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësi për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe:

- organizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe kanë kohëzgjatje normale dy vite akademike.
- përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

3. Programet e studimeve “**Master profesional**” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe :

- organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike.



- përmbillen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimit të kryer.

### **Neni 52**

#### **Pranimi në Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve**

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga njësitet bazë ku ata aplikojnë.

2. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore përkatëse pasi miratohen nga Senati Akademik.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian : anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i gjuhës përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

4. UK mund të njohë kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”.

### **Neni 53**

#### **Cikli i Tretë i Studimeve (Studimet e doktoratës)**

1. Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

2. Për të mundësuar zhvillimin e studimeve të doktoraturës, UK-ja, njësitet kryesore dhe ato bazë, hartojnë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime. Ato aplikojnë për financim pranë AKKSHI-t apo institucioneve të tjera financuese.

3. Kur studimet e doktoratës zhvillohen në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, pjesë të procesit kërkimor, mund të zhvillohen pranë institucioneve bashkëpunuese.

4. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.

5. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore.

Këto programe:

- kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese.
- zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.
- në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

6. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte të tjera apo të vetëfinancohet.

7. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar dhe përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanada-së, bashkëudhëheqësi në institucionin pritës mund të jetë me gradën shkencore “Doktor”.

8. Të dhëna më të hollësishme në lidhje me programet e ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në Rregulloren e studimeve të doktoratës.

#### **Neni 54**

##### **Pranimi në Studimet e Doktoratës**

1. Pranimi në studimet e doktoratës është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Master i shkencave” dhe plotësojnë kriteret e pranimit.

2. Kriteret e pranimit në studimet e doktoratës përcaktohen nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe pasqyrohen në Rregulloren e studimeve të doktoratës. Këto kritere bëhen publike nga institucioni dhe i përcillen QSHA-së, si dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

3. Kriteri pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: *anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht*, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Lista e studentëve fitues dërgohet në QSHA, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

5. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga UK-ja në ministrinë përgjegjëse për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

#### **Neni 55**

##### **Programet e përbashkëta të studimit**

1. Programet e përbashkëta të studimit realizohen në UK, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publik ose jopublik, brenda ose jashtë vendit.

2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta mund të kryhet në një nga/ose në institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.

3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.

4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.

5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

#### **Neni 56**

##### **Programet e studimeve të formimit të vazhduar**

1. UK-ja mund të ofrojë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për plotësim, thellim e konsolidim të njohurive dhe mund të ofrohen si kurse kualifikimi, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit dhe të aftësive profesionale.

2. Struktura e këtyre programeve, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secila njësi përgjegjëse, në bashkëpunim me ministrinë e linjës, nëse kanë kompetencë, sipas kuadrit ligjor për profesionet e rregulluara, dhe bëhen publike nga njësia kryesore.

3. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, UK-ja lëshon certifikatat përkatëse, të cilat regjistrohen në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

4. UK-ja mund të ofrojë edhe kurse përgatitore për programet e studimeve që ofron.

### **Neni 57**

#### **Programet e studimit në fushën e mësuesisë**

1. Programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor, organizohen në dy cikle:

- program i ciklit të parë, “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor;
- program i ciklit të dytë “Master profesional”, që formon mësues të arsimit fillor.

2. Programet e studimit për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, me 120 kredite, sipas fushave përkatëse të formimit.

3. Programet e ciklit të dytë të studimit në fushën e mësuesisë duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.

4. Programet e ciklit të dytë të studimit, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

### **Neni 58**

#### **Ndjekja e një programi të dytë studimi**

1. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Përfshihen nga ky rregull studentët e shkëlqyer, me notë maksimale në hyrje.

2. Për ndjekjen e një programi të dytë studimi, si rregull, pranohen për aplikim kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë, në të cilin kërkojnë të studiojnë, nga të cilët përzgjidhen ata me mesatare më të lartë, brenda numrit të përcaktuar të kuotave të pranimit.

3. Kriteria specifike për t’u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e njësive bazë.

### **Neni 59**

#### **Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies**

1. Studimet në UK zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin.

2. Viti akademik organizohet në semestra, që realizojnë 20 deri në 25 orë (fizike) leksione, seminare, praktika, laboratorë në një javë.

3. Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, e cila përcaktohet bazuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Organizimi i studimeve në UK bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë

në Republikën e Shqipërisë”, ose të një modeli tjetër, në rastin kur ai ofrohet nga UK-ja, i cili lëshon një diplomë të përbashkët ose të dyfishtë me një institucion të huaj.

### **Neni 60** **Gjuha e studimeve**

1. Programet e studimit në UK ofrohen në gjuhën shqipe. Këto programe mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian, të miratuar në aktin përkatës të hapjes së programit të studimit. Përjashtohen nga ky rregull :

- programet e përbashkëta të studimit të ofruara nga UK-ja me institucione të huaja të arsimit të lartë ;
- programet e studimit që kanë për objekt mësimin e gjuhëve të huaja.

2. Në rastin e programeve të studimit që ofrohen nga UK-ja në gjuhë të huaj, studentët duhet të dëshmojnë njohjen e gjuhës së huaj përkatëse në nivelin e nevojshëm për të kryer studime të larta, të përcaktuar vetë universiteti.

### **Neni 61** **Transferimi i studimeve**

1. UK-ja ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë universitetit apo universiteteve të tjera.

2. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.

3. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

4. Njohja kryhet nga universiteti pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve, konform kërkesave dhe standardeve të parapara në Rregulloren e UK-së për Veprimtarinë e Komisionit të Ekuivalentimit të Moduleve dhe Programeve Mësimore.

5. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera nënligjore.

6. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve, merret nga Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë Bazë që pranon studentin.

### **Neni 62** **Kohëzgjatja e studimeve**

1. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

2. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Për këtë:

a. ai u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës.

b. kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të Komisionit të Ekuivalentimit, të njësisë bazë përkatëse, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e saj.

### **Neni 63**

#### **Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomës**

1. Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose certifikatën përkatëse dhe dokumente të tjera që e shoqërojnë atë. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.
2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, si edhe ato të ciklit të dytë shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga UK-ja, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
4. UK-ja nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë:
  - emrin e universitetit,
  - numrin e diplomës origjinale,
  - datën e lëshimit të diplomës,
  - ciklin dhe programin e studimit.
5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
6. Diploma dhe Suplementi i diplomës që ofron UK-ja, forma dhe përmbajtja e tyre janë sipas modelit të përcaktuar në Rregulloren e studimeve të UK-së në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

### **KREU VII**

#### **KËRKIMI DHE VEPRIMTARIA SHKENCORE**

### **Neni 64**

#### **Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UK**

1. UK-ja kryen kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, në mënyrën e përcaktuar në këtë statut dhe sipas objektivave specifike të tij.
2. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në UK, synon edhe në rritjen e cilësisë së arsimit nëpërmjet integritit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore, të metodave, teknikave e teknologjive të reja e të konkluzioneve me karakter teorik e praktik të kërkimit shkencor, përmirëson kualifikimin e personelit akademik dhe krijon mjete materiale për zhvillimin dhe punën në UK.
3. Veprimtaritë kërkimore përcaktohen në rregulloret përkatëse të njësive kryesore, njësive bazë dhe njësive ndihmëse të UK-së, dhe kryhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret e vetë njësive.
4. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:
  - plotësimin e detyrimeve ndaj UK-së, sipas marrëveshjes së punës;

- plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të UK-së, bazë dhe kryesore, për kërkim shkencor, sipas pikës 1 të këtij neni.

### **Neni 65** **Veprimtaritë kërkimore në UK**

1. Kërkimi shkencor, bazë dhe i aplikuar, me interes të gjerë për rajonin, është veprimtari që ndërmerret për të përmbushur misionin e njësisë për kërkim shkencor, sipas standardeve bashkëkohore. Kërkimi shkencor bazë nënkupton studime plotësuese dhe saktësime të mëtejshme për probleme ende të pazgjidhura në fushat e veprimtarisë së njësisë kryesore. Këto studime duhet të synojnë ritmet e zhvillimit teorik bashkëkohor, në koherencë me arritjet në fushat përkatëse, brenda dhe jashtë vendit. Kërkimi shkencor shoqërohet me rinovime teknologjike në fushën analitike, të përpunimit të informacionit etj., për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e tyre. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe aplikative është pjesë integrale e projekt buxhetit të UK-së për çdo vit pasardhës.

2. Temat dhe afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga UK-ja dhe njësitë përbërëse të tij, mbështetur në fushat prioritare të zhvillimit të rajonit dhe vendit, në Planin strategjik të zhvillimit të UK-së, në rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe në burimet financiare në dispozicion.

3. Forma kryesore e realizimit të veprimtarisë kërkimore është projekti. Punonjësit kërkimorë shkencorë të profileve të ndryshme, brenda dhe jashtë njësisë bazë të njësisë kryesore, janë të lirë të grupohen e të përpilojnë projekte në përputhje me fushat e kërkimit shkencor dhe programet publike të zhvillimit të vendit apo sektorëve të veçantë, të ndjekin procedurat e caktuara për shqyrtimin e miratimin e projekteve dhe, pas miratimit, të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre në kohë e me cilësinë e kërkuar.

4. Njësitë kryesore të UK-së hartojnë planin afatmesëm disavjeçar të zhvillimit të tyre. Mbështetur në planin e zhvillimit, hartohen programet vjetore të veprimtarisë së tyre, duke caktuar e vendosur raporte të drejta ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me misionin që ato kanë. Plani i zhvillimit paraqitet në rektorat dhe miratohet në Senatin Akademik.

5. UK-ja kryen shërbime për të tretë si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë tërësisht në favor të UK-së.

6. Masa e shpërbimit të personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, përcaktohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **Neni 66** **Planifikimi dhe vlerësimi i veprimtarive kërkimore**

1. Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të UK, të programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Kërkesa për financimin e programit vjetor të kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar nga buxheti i shtetit, bëhet nga njësitë kryesore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

3. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga njësitë bazë e kryesore të UK-së dhe nga Senati Akademik.

4. Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit.

5. Brenda muajit dhjetor të çdo viti, njësitë kryesore të UK-së, dorëzojnë në Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor një raport për planifikimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore për vitin pasardhës.

6. Veprimtaria kërkimore-shkencore në UK rregullohet nëpërmjet Rregullores për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese.

## **KREU VIII**

### **STUDENTËT, TË DREJTAT, DETYRIMET DHE TË DHËNAT PËR TA**

#### **Neni 67**

#### **Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

1. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në UK. Ky status humbet me marrjen e diplomës, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga UK-ja.

2. Studenti mund t'i pezullojë studimet dhe t'i rifillojë ato, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të UK-së.

3. Studenti nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky nen nxënësit dhe studentët e shkëlqyer, me notë maksimale në hyrje.

#### **Neni 68**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e studentit**

1. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve fillojnë me regjistrimin si student i UK-së dhe përfundojnë me dhënien e diplomës, si dhe në rastin e çregjistrimit të studentit nga UK.

2. Studentët kanë të drejtë:

- Të zgjedhin dhe të zgjidhen si përfaqësues në organet vendimmarrëse të UK-së në nivele të Senatit (10%) dhe të komisioneve, sipas përcaktimeve të këtij Statuti dhe të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë".

- Të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku ata janë regjistruar.

- Të përfitojnë bursë studimi kur përmbushin kriteret e përcaktuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

- Të përdorin infrastrukturën që UK-ja vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga UK-ja.

- Të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në UK.

- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në Këshillin e Studentëve të njësive kryesore përkatëse, si dhe në atë në nivel institucioni.

- Të pajisen me kartën e studentit, e cila është një dokument unik, me anë të cilës studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

3. Studentët kanë detyrë:

- Të zbatojnë rregullat e përcaktuara në Statut, si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UK-së dhe njësisë kryesore.

- Të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.

- Të paguajnë tarifën e përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë" dhe nga institucioni, si dhe tarifën e shërbimeve që u ofron UK-ja.

- T'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike.

- Të respektojnë Kodin e Etikës së UK-së.
- 4. Studentit përsëritës i ndërpritet mbështetja nga fondet publike, me përjashtim të rasteve të forcave madhore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe aktit/eve përkatëse nënligjore në fuqi.

### **Neni 69** **Këshillat e Studentëve**

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore dhe institucioni.
2. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të tyre, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UK-së.
3. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit, deri në përfundim të mandatit të nisur.
4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike jashtë UK-së. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në Rregulloren e UK-së, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.
5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UK-së, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetorë paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
6. UK-ja mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimtari të tyre.

### **Neni 70** **Masat disiplinore për studentët**

1. Për studentin që nuk respekton rregullat e përcaktuara në Statutin, rregulloret apo aktet e tjera të brendshme të UK-së dhe/apo njësisë kryesore parashikohet dhënia e masave disiplinore si vijon:
  - vërejtje,
  - vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga UK-ja,
  - përjashtim i përkohshëm nga UK-ja, deri në një vit;
  - përjashtim nga UK-ja.
2. Veprimet apo mosveprimet që përbëjnë shkelje të rregullave, procedura e trajtimit të tyre, lloji i masës disiplinore për çdo shkelje dhe autoriteti/organi drejtues që i jep ato, përcaktohen në Rregulloren e Studimeve të UK-së.

### **Neni 71** **Dokumentacioni i procesit mësimor**



1. Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, « Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë», UK-ja detyrohet të mbajë në formë të shkruar:

- regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UK. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

- regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UK, sipas programeve të studimit. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

- regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej UK-së. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

2. Regjistrat shpërndahen nga ministria përgjegjëse për arsimin kundrejt tarifës përkatëse që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. UK-ja duhet të plotësojë elementet e regjistrave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Dokumentacioni, pas plotësimit përfundimtar të tij, depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e UK-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e institucionit.

## **Neni 72**

### **Baza e të dhënave të studentëve**

1. UK-ja ka detyrimin ligjor që të ruajë të dhënat personale të studentëve.

2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen nga UK-ja, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **KREU IX**

### **SIGURIMI I CILËSISË**

## **Neni 73**

### **Organizimi strukturor**

1. UK-ja është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë, funksionon rrjeti i cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UK, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL.

2. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i ngritur brenda Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. Brenda këtij sektori funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi kryesore. Pranë çdo njësie kryesore ngrihet Grupi i Vlerësimit të Brendshëm me përfaqësim nga çdo njësi bazë dhe nga organizimet studentore.

3. Rrjeti i cilësisë harton rregulloren e funksionimit të tij në formën e manualit si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse.

4. UK-ja përcakton në buxhetin e institucionit fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të cilësisë

5. Senati i UK-së miraton të gjithë dokumentacionin për sistemin e cilësisë.

## **Neni 74** **Sigurimi i cilësisë**

1. Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë planifikon organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për të realizuar këtë ngrihet Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 4 janë përfaqësues të personelit akademik nga njësitë kryesore, 1 përfaqësues nga administrata, 1 përfaqësues i studentëve dhe 1 përfaqësues ekspert i jashtëm. Kjo njësi ngrë grupin e vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizmat studentore. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet në njësinë përkatëse. Ai ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Vlerësimi i brendshëm realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL-it. Përfundimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmësmësimor dhe administrativ dhe studentët. Drejtuesit e njësive të vlerësuara publikojnë rezultatet e vlerësimit të kryer.

2. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo vlerësimi institucional organizohet si rregull një herë në vit. Nëse është e nevojshme, njësia mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, veprimtaritë që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.

3. Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me ASCAL-in organizon trajnim të anëtarëve të grupit të vlerësimit. Për anëtarët e grupit të vlerësimit njësia merr masat e sigurimit të kushteve të përshtatshme për realizimin e kësaj detyre.

4. Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë mban lidhje të vazhdueshme me Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.

5. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në UK realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

6. UK-ja i nënshtrohet vlerësimit të parë, vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike nga ASCAL.

7. Vlerësimi i parë institucional dhe vlerësimi i programeve kryhen para lëshimit të diplomave të para. Vlerësimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit.

8. Vlerësimi periodik kryhet pasi të jetë fituar akreditimi i parë, brenda afatit kohor të vlefshmërisë së tij.

9. UK-ja i nënshtrohet procesit të vlerësimit të mësimdhënies, cdo tre vjet, nga ASCAL-i dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

10. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin E Lartë. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ASCAL-i mund të bashkëpunojnë me agjenci të huaja të sigurimit të cilësisë, që janë anëtare të rrjetit ENQA.

## **KREU X** **PRONAT DHE FINANCIMI I UK - së, MARRËDHËNIET ADMINISTRATIVE** **DHE FINANCIARE**

### **Neni 75** **Pronat e paluajtshme të UK-së**

1. UK-ja ushtron veprimtarinë e saj në pronat e paluajtshme, që ka në administrim dhe përdorim, të cilat i shërbejnë institucionit për të garantuar përmbushjen e misionit të tij.

2. UK-ja ka detyrimin të ruajë dhe të mirëmbajë pronat në administrim dhe nuk mund të ndryshojë destinacionin e tyre. UK-ja mund të zhvillojë pronat me miratim paraprak të subjektit që i ka kaluar pronën në administrim.

### **Neni 76** **Financimi i UK-së**

1. Financimi i UK-së, bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

### **Neni 77** **Autonomia financiare e UK-së**

1. Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, UK-ja funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.

2. UK-ja harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.

3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga UK-ja përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.

4. Përdorimi i fondeve publike nga UK-ja bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

### **Neni 78** **Burimet e financimit të UK-së**

1. UK-ja financohet nga:

- Buxheti i Shtetit
- Pagesat e studentëve për arsimim
- Të ardhurat për shërbimet e kryera
- Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta
- Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi
- Veprimtari kërkimore-shkencore.

2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik, ndahet ndërmjet personelit akademik dhe UK-së, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit.

3. Mënyra e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e përcaktuara në këtë nen, me përjashtim të të ardhurave nga buxheti i shtetit, përcaktohet në Rregulloren financiare të UK-së, që miratohet nga Bordi i Administrimit.

### **Neni 79** **Shpërndarja e fondeve nga buxheti i shtetit**

1. Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, fondet nga buxheti i shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:

- Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
  - Granti i mësimdhënies;
  - Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.
2. Modeli i financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Për institucionet publike të arsimit të lartë, zbatimi i skemës së financimit, sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

### **Neni 80**

#### **Granti i politikave të zhvillimit**

1. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin:
  - fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike;
  - fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë.
2. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor.
3. Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë shpërndahet mbi bazën e projekteve që ato paraqesin, sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.
4. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton me udhëzim prioritetet, temat e shpërndarjes, formën e aplikimit për grantin, si dhe miraton grantin e politikave të zhvillimit të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazën e aplikimit apo të prioritetëve strategjike të zhvillimit të vendit.

### **Neni 81**

#### **Granti i mësimdhënies**

1. Granti i mësimdhënies përfshin:
  - fondin për institucionet publike të arsimit të lartë;
  - fondin e mbështetjes studentore.
2. Fondi i mbështetjes studentore përfshin tri kategori financimi:
  - bursat e studimit për studentët e shkëlqyer
  - bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar
  - bursat e studimit për studentët që i përkasin shtresave sociale në nevojë.
3. Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë maksimale në hyrje, pavarësisht programit të studimit në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.
4. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë u shpërndahen studentëve të UK-së, të cilët plotësojnë kriteret për t’u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ky grant shpërndahet nga AKFAL-i.

## **Neni 82**

### **Granti i punës kërkimore-shkencore**

1. Granti i punës kërkimore-shkencore përfshin fondet për kërkimin shkencor.
2. Pjesë e këtij granti janë edhe fondet për studimet e doktoratës, të cilat u jepen institucioneve të arsimit të lartë mbi bazën e aplikimit. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.
3. Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie bëhet nga AKKSHI, mbi bazën e projekteve që paraqesin institucionet, sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe në ligjin vjetor të buxhetit.
4. Kriteri bazë i renditjes së institucioneve të kërkimit shkencor nga AKKSHI dhe përcaktimi i masës së financimit, të përfituar prej AKFAL-it, për IAL-të publike është vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor. Në lidhje me këtë, UK-ja merr masa për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

## **Neni 83**

### **Administrimi i çështjeve financiare**

1. Administrimi i çështjeve financiare të UK-së kryhet nga strukturat përkatëse të UK-së, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Statutin, rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të universitetit.
2. Kompetencat dhe procedurat administrative në përgjithësi dhe të çdo njësie ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative në veçanti, parashikohen në rregulloret përkatëse.

## **Neni 84**

### **Marrëdhëniet financiare**

1. Projektbuxheti/buxheti në UK hartohet në nivel institucioni.
2. Për përgatitjen e projektbuxhetit:
  - secila njësi bazë duhet të paraqesë pranë dekanatit propozimet brenda datës 20 qershor.
  - dekanatet duhet të paraqesin pranë Rektoratit propozimet brenda datës 30 qershor.
3. Administratori i UK-së harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij. Ky projektbuxhet i paraqitet për miratim Senatit Akademik nga Rektorati.
4. Me kërkesën e Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miraton projektbuxhetin e universitetit.

## **Neni 85**

### **Kontrolli dhe auditimi**

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UK dhe në njësitë e tij përbërëse realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm të UK-së.
2. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të kësaj njësie përcaktohet në rregulloren përkatëse të saj të miratuar nga Bordi i Administrimit.

## **KREU XI PROCEDURAT ZGJEDHORE**

### **Neni 86 Asambleja e personelit akademik**

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore ka këto funksione:
  - zgjedh rektorin e UK-së;
  - zgjedh anëtarët e Senatit Akademik të UK-së;
  - zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore;
  - krijon dhe zgjedh anëtarët e Komisioneve të Përhershme të njësisë kryesore.
3. Asambleja e personelit akademik të njësisë bazë zgjedh drejtuesin e njësisë bazë.

### **Neni 87 Procedura të zgjedhjeve në UK**

1. Zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të UK-së zhvillohen sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë” dhe në Rregulloren e Zgjedhjeve të Universitetit, në të cilën përcaktohen kriteret për hartimin e listave zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, procesin e votimit, kriteret e vlefshmërisë e të numërimit të votave, rregullat për shpalljen e rezultatit dhe të fituesve, procesin dhe afatet e ankimit.
2. Rregullorja për zgjedhjet e para, sipas ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë”, të autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik, miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin.

## **KREU XII DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 88 Vula & Stema**

1. UK-ja ka vulën zyrtare sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Vula ka diametrin 40 mm, me stemën shtetërore në qendër dhe rreth saj shënohet: Republika e Shqipërisë (sipër) dhe Universiteti “Fan S. Noli” (poshtë), e pasqyruar në anekset, e këtij statuti.

### **Neni 89 Simbolet**

1. Simbolet e UK-së, të pasqyruara në anekset bashkëngjitur këtij statuti janë si më poshtë:
  - Stema
  - Flamuri
  - Himni
2. Fakultetet e UK-së kanë vulat e tyre zyrtare dhe miratojnë stemat përkatëse, nisur nga modeli i stemës së UK-së.

**Neni 90**  
**Miratimi i rregulloreve**

1. Brenda një muaji nga data e miratimit të këtij statuti, nga ministri përgjegjës për arsimin, apo brenda një muaji nga mbarimi i afatit dymujor për t'u shprehur ministri, Senati Akademik i UK-së miraton Rregulloren e UK-së, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në këtë statut.

2. Rregulloret e tjera të parashikuara nga ligji dhe ky statut, miratohen nga organet përkatëse, brenda një muaji nga miratimi i Rregullores së UK-së.

**Neni 91**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky statut hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Rektori i UK-së, të nesërmen e datës së miratimit nga ministri përgjegjës për arsimin, apo të nesërmen e datës së mbarimit të afatit dymujor për t'u shprehur ministri.

2. Nëse ministri ia kthen këtë statut për ripunim UK-së, për mospërputhje të tij me ligjin, atëherë brenda shtatë ditëve nga kthimi i statutit, Senati Akademik mblidhet për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet përkatëse. Edhe në këtë rast procedura është e njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 2, të nenit 33, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 92**  
**Dispozita kalimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohet statuti ekzistues, miratuar sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Rregulloret e UK-së, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe këtij statuti dhe që nuk bien ndesh me to, do të zbatohen deri në miratimin e rregulloreve të parashikuara nga ligji në fjalë dhe ky statut.
3. Riorganizimi i UK-së sipas kërkesave të pikës 1, të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, kryhet bazuar në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të pikës 2, të po këtij neni të ligjit.

**MIRATUAR:**

**SENATI AKADEMIK**  
**KRYETARI**  
Prof. dr. ALI JASHARI